



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 98 Akti

Nr. 254 Vendimi
Tiranë, më 4.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 11.3.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Zj. Entela Shedula**, me detyrë gjyqtare/drejtuese e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, me detyrë gjyqtare/drejtuese e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.11.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisionere Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim, DSIK); dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim, KLD).

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula*”.

¹ILDKPKI me shkresën me nr.*** prot., datë 12.2.2018, ka depozituar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës nr. 4, të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 3.3.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, znj. Entela Shedula i janë garantuar të drejtat, si: për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

Në datën 4.3.2020 për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit iu dha pesë ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Znj. Entela Shedula, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datat 10.12.2019, 27.1.2020 dhe 9.3.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimet e bëra elektronikisht në datat 28.1.2020, 4.3.2020 dhe 29.5.2020. Trupi gjykues pas prapësimeve dhe provave depozituar nga subjekti në datën 10.12.2019, vendosi të rregullohet hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit.

Gjithashtu, trupi gjykues u mbledh pas seancës dëgjimore të datës 30.1.2020, si dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi, vendosi riçeljen e hetimit për kryerjen e disa verifikimeve dhe kërkime shtesë për marrjen e provave të reja. Pas mbylljes së hetimit administrativ shtesë në datën 3.3.2020 subjekti u njoh më 4.3.2020 me hetimin shtesë dhe u ftua serish në seancë dëgjimore.

Seancat dëgjimore për subjektin Entela Shedula u zhvilluan në datat 30.1.2020 dhe 11.3.2020 në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në këto seanca subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe me përfaqësues ligjor dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

³ Me shkresën nr*** prot., datë 16.05.2018, dërgohet KLD-së.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, znj. Entela Shedula ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, me detyrë gjyqtare/drejtuese në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, përfshin të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën e pasurisë, shtojca nr. 2, dorëzuar në ILDKPKI në datë 27.1.2017, në zbatim të ligjit subjekti ka deklaruar pasuritë vijuese:

1. Pasuria e llojit ndërtesë me sip. ndërtimore 139.3 m², e përbërë nga godinë e kombinuar **katëshe: kati përdhes social ekonomik me sip. 139.3 m²; kati i parë me sip. 174.9 m²; dhe kati i dytë me sip. 174.9 m².

Vlera e deklaruar: 8.450.000 lekë.

Pjesa në përqindje: subjekti zotëron 50 %, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Burimi i krijimit: Puna e bashkëshortit si emigrant ekonomik në Itali nga viti 1991 e në vijim, të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit dhe vjehrrit, kredi në Fondin B, të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, etj.

Deklarimi në DPV: Nga z. K. Shedula (vjerrri i subjektit) është deklaruar si pasuri e trashëguar nga prindërit (trualli) e fituar me kontratë dhurimi nr. ***, datë 15.9.1973. Trualli i përfitur me trashëgimi dhe banesa ndërtuar me kursime të familjes + shitje e pemishtes me sip. 2378 m² + kredi 1.800.000 lekë (e shlyer).

Mënyra e fitimit: Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është fituar me leje legalizimi nr. ****, datë 31.3.2016, regjistruar në ZVRPP-në Kavajë.

1.1 Burimi i krijimit në DPV-në para fillimit të detyrës

Subjekti në deklarin periodik vjetor në vitin 2004 ka bashkangjitur dhe deklarin e shtetasit K Shedula (vjehrrri i subjektit), në të cilin është deklaruar: “*Shtëpi banimi me kat përdhes, 150 m² çdo kat, kati i parë i përfunduar, kati i dytë karabina, në shumën 6.200.000 lekë, me pjesë takuese 1/3 pjesë (ai, bashkëshortja dhe djali).*”

Burimi i krijimit për ndërtimin e kësaj pasurie janë deklaruar kursimet në vite të familjes së tyre të origjinës, shitje e pemishtes me sip. 2.378 m² dhe kredi në vlerën 1.800.000 lekë e shlyer”.

1.2 Deklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”

Subjekti shpjegoi se sipas deklarimeve të vjehrrit (z. K.Shedula), banesa ka filluar së ndërtuari në vitin 1995. Subjekti ka deklaruar se: “Sipas certifikatës së martesës ka lidhur martesë në datën 10.11.1999, por *de facto* është martuar në dhjetor të vitit 2001 dhe deri në këtë kohë nuk ka kontribuar në familjen Shedula. Kur subjekti është martuar, kati përdhes dhe kati i parë kanë qenë të përfunduara, ndërsa kati i dytë karabina ka qenë i papërfunduar. Në janar të vitit 2002 kanë filluar kontributet e saj si bashkëshorte dhe si pjesëtare e familjes Shedula. Të ardhurat për ndërtimin e banesës deri në këtë moment janë nga:

- Të ardhura nga puna e bashkëshortit të subjektit z. F. Shedula si emigrant ekonomik në Itali⁴ në vitet 199 – 2003, në shumën totale 30.935 euro.

⁴ Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj F.Shedula ka punuar si emigrant në Itali nga viti 1991 e në vazhdim, i cili ka punuar sipas të dhënave nga INPS për periudhën:

- 1.1.1994 - 31.1.1994, në vlerën 854,73 euro;
- 1.2.1994 - 21.5.1994, në vlerën 3.208,23 euro.

- Të ardhura nga aktiviteti privat⁵, tregti me shumicë të artikujve të përzierë, ushqimore, pije dhe duhan për vitet 1995 – 2005, në shumën totale 3.164.150 lekë.
- Kredi nga Fondi B, në shumën 300.000 lekë, datë 19.10.2000, sipas kontratës nr. ***, datë 16.10.2000.
- Kredi e marrë nga Fondi B, në vlerën 600.000 lekë, datë 28.8.2001, sipas kontratës nr. ***, datë 28.8.2001.
- Kontratë shitblerjeje trualli, nr. ***, datë 31.10.2001, shitës K. Sh etj., blerës N. H, me sip. 550 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, lagjja “Z”, Kavajë, në vlerën 1.000.000 lekë. Z. K. Shedula ka përfituar 1/4 e vlerës, shumën prej 250.000 lekësh.
- Kontratë shitblerjeje trualli, nr. ***, datë 31.10.2001, shitës K. Shedula, etj., blerës M.A me sip. 440 m², pasuri me nr. ***, z. k. ****, lagjja “Z”, Kavajë, në vlerën ¼ e shumës 900.000 lekë, baraz me 225.000 lekë.
- Kontratë shitblerjeje e mjetit kamionçinë, tipi “F **”, me shasi nr. ***, shitës Fatmir Shedula, blerës D. D sipas kontratës nr. ***, datë 6.11.2002, në vlerën 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerjeje trualli, nr. ***, datë 5.5.2003, shitës K. Shedula etj., blerës L. K me sip. 500 m², me nr. pasuri ***, z. k. ***, lagjja “Z”, Kavajë, në vlerën 1.500.000 lekë. Z. K. Shedula ka përfituar 1/4 e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, shumën prej 375.000 lekësh.
- Kontratë shitblerjeje trualli, nr. *** datë 29.8.2003, shitës K. Shedula etj., blerës Q.P, me sip. 80 m², me nr. pasurie **, z. k. ***, lagjja “Z”, Kavajë, në vlerën 1.200.000 lekë. Z. K. Shedula ka përfituar 1/4 e çmimit të shitjes, shumën prej 300.000 lekësh.
- Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat “Kopsht⁶ për fëmijë” me NIPT K***U, i bashkëshortit F. Shedula, për vitet 2006 - 2016, fitimi *neto* sipas deklaratave të lëshuara prej tij është në vlerën 6.127.334 lekë.

-
- 1.3.1996 - 11.6.1996, në vlerën 2.794,03 euro;
 - 1.1.1998 - 30.6.1998, në vlerën 5.316,40 euro;
 - 1.11.1999 - 6.12.1999, në vlerën 1.905,72 euro;
 - 1.1.2002 - 31.12.2002, në vlerën 12.272,00 euro;
 - 1.1.2003 - 14.5.2003, në vlerën 4.586,00 euro (subjekti argumenton se këto të ardhura nuk i ka deklaruar më parë, pasi nuk mund të siguronte të dhëna), si dhe në të zezë si të gjithë emigrantët e tjerë.

⁵ Aktiviteti regjistruar me vendimin e gjykatës nr. 28, datë 17.1.1995, me nr. NIPT J***H dhe kod fiskal ***. Subjekti ka shpjeguar se nga viti 1995 – 1998 ka ushtruar aktivitet, ka pasur fitim, por bilancet nuk ekzistojnë. Kjo edhe sipas shkresës nr. ***, datë 12.3.2015, të dorëzuar në ILDKPKI.

- Për vitin 1999, fitimi *neto* është me - 88.300 lekë, por në këtë bilanc është pasqyruar edhe fitimi *neto* i vitit 1998, në vlerën 174.677 lekë, një fakt provues që bashkëshorti im ka dorëzuar bilance, por që nuk ekzistojnë.
- fitimi *neto* për vitin 2000 është 515.019 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2001 është 437.490 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2002 është 588.747 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2003 është 855.974 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2004 është 458.303 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2005 është 222.240 lekë.

⁶ Nga aktiviteti privat “Kopsht për fëmijë” me NIPT K***U, i bashkëshortit F. Shedula, fitimi *neto* sipas deklaratave të lëshuar prej tij është:

- fitimi *neto* për vitin 2006 është 350.000 lekë,
- fitimi *neto* për vitin 2007 është 450.000 lekë; fitimi *neto* për vitin 2008 është 480.000 lekë; fitimi *neto* për vitin 2009 është 606.000 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2010 është 606.000 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2011 është 793.840 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2012 është 793.840 lekë; fitimi *neto* për vitin 2013 është 775.360 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2014 është 368.777 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2015 është 274.306 lekë;
- fitimi *neto* për vitin 2016 është 629.211 lekë.

- Të ardhurat e subjekti nga pagat nga ushtrimi i detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për periudhën 2002 – 2016⁷.
- Të ardhurat e përfituara nga z. F. Shedula pranë shoqërive “K” sh.p.k.,⁸ “K” sh.p.k., dhe “AKF P” sh.p.k., për periudhën 9.5.2008 – 23.12.2016, në shumën totale prej 5.717.270 lekësh.
- Kredi e marrë nga “T. B”, kredimarrës F dhe Entela Shedula, dorëzanës K. Shedula, në vlerën 2.000.000 lekë, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 17.5.2005.
- Kredi e marrë nga “R. B”, kredimarrës Entela dhe F. Shedula, në vlerën 2.500.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 4.2.2010.
- Kredi e marrë nga “C. B”, kredimarrës F. Shedula, dorëzane Entela Shedula në vlerën 700.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 20.6.2011.

1.3 Hetimi i kryer nga Komisioni për burimin e krijimit

Për të saktësuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjektit iu kërkua që të deklarojë në mënyrë shteruese burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe vitet përkatëse të ndërtimit. Subjekti ka shpjeguar⁹ se: *“Kati përdhes social ekonomik me sip. 139.3 m², kati i parë i përfunduar dhe karabina e katit të dytë është ndërtuar deri në vitin 1999. Kosto e ndërtimit deri në fund të vitit 1999 është 3.650.675 lekë.*

Burimi i krijimit të kësaj pasurie është nga puna e bashkëshortit si emigrant ekonomik nga viti 1991 deri në vitin 1994, i cili ka punuar në Metaponto, Itali në punë të ndryshme si dhe në një pikë karburanti Stazione di Servizio AGIP Sulla SS 106 Jonica, Metaponto i pasiguruar. Për këtë periudhë rezulton se ka qenë i siguar pjesërisht, kështu sipas të dhënave nga INPS ka qenë i siguar për periudhën 1.1.1994 - 31.1.1994 duke përfutuar vlerën 854,73, euro, 1.2.1994 – 21.5.1994 në vlerën 3.208,23 euro, ku rezulton se ka punuar pranë Ninno Alberto Mario. Nga data 1.3.1996 deri më 11.6.1996 ka punuar pranë Schiraldi Nicola duke përfutuar vlerën 2.794.03 euro. Nga data 1.1.1998 deri më 30.6.1998 ka punuar pranë Schiraldi Gaitano duke përfutuar vlerën 5.316.40 euro. Nga data 1.11.1999 deri më 6.12.1999 ka punuar pranë Cooperative di Lavoro Team Service, duke përfutuar vlerën 1.905,72 euro.

*Në vitet 2000 – 2001 ka vazhduar ndërtimi i pasurisë nr. 2/278, ndodhur në z. k. *** Kavajë, për ndërtimin me mur tulle, suvatim, shtrim i katit të dytë dhe ndërtimi karabina i katit të tretë. Kosto e ndërtimit deri në fund të vitit 2001 është 2.549.325 lekë.*

*Burimi i krijimit janë nga të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti F. Shedula nga aktiviteti privat shitblerje e rrobave të përdorura me NIPT J***H, kështu nga bilanci i vitit 2000 është pasqyruar*

⁷ Në krijimin e pasurisë bashkëshortore kam kontribuar edhe unë nga ushtrimi i detyrës si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Fitimi *neto* për vitin 2002 është në vlerën 506.065 lekë; fitimi *neto* për vitin 2003 është në vlerën 424.632 lekë; fitimi *neto* për vitin 2004 është në vlerën 766.578 lekë; fitimi *neto* për vitin 2005 është në vlerën 630.131 lekë; fitimi *neto* për vitin 2006 është në vlerën 822.512 lekë; fitimi *neto* për vitin 2007 është në vlerën 839.222 lekë; fitimi *neto* për vitin 2008 është në vlerën 818.768 lekë; fitimi *neto* për vitin 2009 është në vlerën 957.871 lekë; fitimi *neto* për vitin 2010 është në vlerën 973.496 lekë; fitimi *neto* për vitin 2011 është në vlerën 1.016.335 lekë; fitimi *neto* për vitin 2012 është në vlerën 1.076.227 lekë; fitimi *neto* për vitin 2013 është në vlerën 1.125.372 lekë; fitimi *neto* për vitin 2014 është 1.435.784 lekë; fitimi *neto* për vitin 2015 është në vlerën 1.291.562 lekë; fitimi *neto* për vitin 2016 është në vlerën 1.450.999 lekë.

⁸ Sipas vërtetimit të datave 7.4.2011, 18.3.2012 lëshuar nga shoqëria “K” sh.p.k. dhe për vitin 2008 sipas llogarisë bankare i është kredituar nga “T. B” shuma e përfutuar *neto* 400.000 lekë për vitin 2009 i është kredituar shuma e përfutuar *neto* 720.000 lekë; për vitin 2010 i është kredituar shuma e përfutuar *neto* 840.000 lekë, nga “C. B”; për vitin 2011 i është kredituar shuma e përfutuar *neto* 840.000 lekë; për vitin 2012 i është kredituar shuma e përfutuar *neto* 840.000 lekë; për vitin 2013 pjesërisht është kredituar shuma nga “C. B.” dhe pjesërisht nga banka “S. G. A” nga shoqëria “K” në shumën *neto* 637.270 lekë; për vitin 2014 i është kredituar shuma e përfutuar *neto* 780.000 lekë pjesërisht nga shoqëria “K” nëpërmjet bankës S.G.A dhe “V.B”, si dhe vërtetimi datë 27.3.2014, lëshuar nga shoqëria “K” sh.p.k.; për vitin 2015 ka fituar *neto* shumën 65.000 lekë nga shoqëria “K” sipas vërtetimit, datë 10.3.2015, lëshuar nga shoqëria “K” sh.p.k. dhe shuma 90.000 nga shoqëria “AKF P” sh.p.k. për vitin 2016 i është kredituar shuma e përfutuar 505.000 lekë nga “C. B”, si dhe vërtetimi datë 23.12.2016 lëshuar nga shoqëria “A.K.F P” sh.p.k.

⁹ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 11.10.2019,

fitimi neto në vlerën 515.019 lekë. Në bilancin e vitit 2001 është pasqyruar fitimi neto në vlerën 437.490 lekë.

Në vitet 2006 ka vazhduar ndërtimi i pasurisë nr. ***, ndodhur në z. k. *** Kavajë muraturë, shtresë pllakash i katit të tretë me kosto të ndërtimit 1.250.000 lekë. Burimi i krijimit nga kredia nr. ***, datë 17.5.2005.

Në vitet 2010 ka vazhduar ndërtimi pasurisë nr.***, ndodhur në z. K.*** në Kavajë me kosto të ndërtimit 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit nga kredia nr. ***, datë 4.2.2010. Në vitin 2010 ka përfunduar kati i fundit i kësaj ndërtese”.

Subjekti ka shpjeguar¹⁰ se: “Pasuria banesë *-katëshe, nuk është ndërtuar nga ndonjë shoqëri ndërtimi. I gjithë ndërtimi i banesës është bërë nga punëtorë të cilët janë paguar për punën e tyre, por nuk disponohen mandate arkëtimi apo fatura pasi pagesat bëheshin në dorë për punën e kryer dhe për blerjet e materialeve”.

1.4 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Kavajë¹¹, konfirmon se në emër të shtetasve F dhe Entela Shedula është regjistruar në bashkëpronësi pasuria me nr. ***-ND, e llojit ndërtesë, me sip. 139.3 m² (godinë e kombinuar * kate). Kati përdhes me sip. 139.3 m², kati i parë me sip. 174.9 m² dhe kati i dytë me sip. 174.9 m². Pasuria është fituar sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 31.3.2016. Nga aktet rezulton se është regjistruar vetëm ndërtesa.

Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë Jug¹², konfirmon se shtetasi F. K. Shedula është pajisur me lejen e legalizimit nr.*** datë 31.3.2016. Bashkëlidhur shkresës: vetëdeklarimi për legalizim të banesës * kat magazinë dhe * kate për banim; certifikatë familjare; fotografi të ndërtesës; fatura arkëtimi; mandatpagesa; vendim për kualifikimin e ndërtimit informal; leje legalizimi nr. *** datë 31.3.2016, për godinën e kombinuar *-katëshe, e ndodhur në K, me sip.139.3 m² (për aktivitet sip. 139.3 m², për banim sip. 349.8 m²); shkresë përcjellëse; prokurë e posaçme dhe hartë treguese.

Nga verifikimi i akteve, depozituar nga ALUIZNI, rezulton se në vitin 2006 banesa ishte e mbaruar, bashkë me katin e fundit. Nga fotot duket se kati i fundit ishte i ndërtuar por nuk ishin përfunduar punimet e brendshme, nuk kishte dritare, dyer, etj.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë¹³, ka depozituar praktikën e plotë të legalizimit të pasurisë me nr. ***, z. k. ***, e llojit ndërtesë me sip. ndërtimore 139.3 m², e përbërë nga godinë ndërtesë *-katëshe.

Nga verifikimi rezultoi se referuar lejes së legalizimit nr. *** datë 31.3.2016, lëshuar për këtë pasuri, ishte parashikuar se “Titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”. Referuar dokumentit hipotekor, të datës 5.5.2016, është bërë regjistrimi vetëm i ndërtesës *-katëshe, por jo i truallit.

QKB-ja¹⁴ konfirmoi se shtetasi F.Shedula, figuron i regjistruar si person fizik, me NIPT K***H. Sipas ekstraktit historik rezulton se subjekti është regjistruar në datën 1.3.2006, me objekt veprimtarie aktivitetin “Kopsht për fëmijë”. Me vendimin nr. 53, datë 13.2.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Kavajë është bërë regjistrimi si person fizik. Sipas ekstraktit të QKB-së ky aktivitet është me status të pezulluar, në datën 15.9.2017. Nga verifikimi *online* i faqes së QKB-së, ky subjekt vazhdon të jetë i pezulluar.

¹⁰ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 16.9.2019.

¹¹ Me shkresat nr. *** prot., datë 5.10.2018.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2018.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2020.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2018.

Shtetasi F.Shedula figuron administrator dhe ortak i vetëm në personin juridik “Kopshti i engjëjve” sh.p.k., regjistruar me vendim nr. ***, datë 20.6.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet nipt.

DRT-ja Durrës¹⁵ konfirmon se shtetasi F. Shedula figuron i regjistruar me NIPT J***H. Për këtë subjekt ka të dhëna sipas tabelës:

Viti	Fitimi pas tatimit
1998	174.677 lekë
1999	Humbje -88.300 lekë
2000	515.019 lekë
2001	437.400 lekë
2002	588.747 lekë
2003	855.974 lekë
2004	458.303 lekë

Shtetasi F. Shedula figuron i regjistruar me NIPT K***H me aktivitet “Kopsht për fëmijë”. Për këtë subjekt ka të dhëna, si vijon: për vitin 2006, është deklaruar xhiro vjetore e parashikuar në vlerën prej 1.200.000 lekësh; për vitin 2007 deklarimi bëhej në Bashkinë Durrës; për vitet 2008 dhe 2009 nuk disponohet informacion për subjektin, pasi ka qenë me qarkullim nën xhiron 2.000.000 lekë dhe nuk ka pasur detyrim ligjor të dorëzojë F.D.P.; për vitin 2011, xhironja është në vlerën 1.984.600 lekë; dhe për vitin 2012 xhironja është në vlerën 1.964.600 lekë.

DRT-ja Durrës¹⁶ konfirmon se: shtetasi F. Shedula ka qenë i regjistruar, si person fizik në datën 20.3.2006, me NIPT K***H, me aktivitet “Kopsht për fëmijë”, me adresë lagja nr. **, Rr. “Q. K”, objekt **katësh, kati i parë, godina nr. ***

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2019, ka dhënë informacion mbi qarkullimin vjetor të deklaruar, taksat e biznesit të vogël, tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe datat e pagesave të tyre për aktivitetin “Kopsht për fëmijë” për vitet 2006 – 2013. Të dhënat që ka depozituar Bashkia Kavajë përputhen me të dhënat e pretenduara nga subjekti dhe vërtetimin e Bashkisë Kavajë me nr. *** prot., datë 27.11.2019, depozituar prej saj, pas kalimit të barrës së provës.

Komisioni i është drejtuar **Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës** për të saktësuar të dhënat e disponuara nga Bashkia Kavajë dhe për mospërputhjet që rezultojnë për të dhënat mbi qarkullimin për të njëjtën periudhë që këto dy institucione kanë disponuar.

DRT-ja Durrës¹⁷ ka depozituar informacion për tatimpaguesin F. Shedula me NIPT K***H, pas riverifikimit të dosjes së subjektit, ku konfirmojnë se në dosjet e bilanceve në arkivën e DRT-së Durrës, ndodhen bilancet për vitet 2011 dhe 2012, si dhe tabela e llogaritjes së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin viti 2006.

Xhiro e parashikuar për vitin 2006 = 1200.000 lekë sipas deklaratës së tatimpaguesit.

Xhiro e parashikuar për vitin 2006 = 2.000.000 lekë sipas tabelës së llogaritjes së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2018.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.8.2018, dërguar nga DRT-ja Durrës.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2020.

Për vitin 2007 deklarimi bëhej në Bashkinë Kavajë.

Për vitet 2008 dhe 2009, subjekti në dosje nuk disponon informacion pasi ka qenë me qarkullim nën xhiro në vlerën prej 2.000.000 lekësh dhe nuk ka pasur detyrim ligjor që të dorëzojë F.D.P.

Viti 2011 xhiro = 1.984.600 lekë.

Viti 2012 xhiro = 1.964.600 lekë.

Viti 2013 nuk ka deklarime në sistem.

Tatimpaguesi F. Shedula, referuar sistemit C@TS, ka të dhëna në tabelën, si vijon:

Viti	2014	2015	2016	2017
Të ardhurat/lekë	875.000	995.400	1.318.000	852.000
Fitimi /lekë	398.678	431.200	629.211	310.558

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj¹⁸ konfirmon se shtetasi F. Shedula rezulton se ka qenë i punësuar dhe ka marrë pagë, si vijon:

- për periudhën dhjetor 2011 – gusht 2013, në shoqërinë “K” sh.p.k., me NIPT K***O;
- për periudhën shtator 2013 – qershor 2015, në shoqërinë “K” sh.p.k., me NIPT L***U;
- për periudhën shtator 2015 – qershor 2017, në shoqërinë “AKF P” sh.p.k., me NIPT L***V.

ISSH-ja¹⁹ konfirmon se:

- shtetasja Entela Shedula ka përfituar të ardhura nga paga si e punësuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, me NIPT K***T, për periudhën janar 2012 – prill të 2017;
- shtetasi F.Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën janar 2012 – nëntor 2012, si i punësuar në shoqërinë “K” sh.p.k., me NIPT K***O;
- shtetasi F. Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2014, si i punësuar në shoqërinë “K” sh.p.k., me NIPT L***U;
- shtetasi F.Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën shtator 2015 – prill 2017, si i punësuar në shoqërinë “AKF P” sh.p.k , me NIPT L***V.

1.5 Analiza e fakteve

i. Në lidhje me vërtetësinë e deklaramit për burimin e krijimit

Konstatohet se deklarimi i subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 nuk përputhet me deklaratën “Vetting”, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

ii. Në lidhje me kontributin financiar të subjektit

Subjekti ka pretenduar se ka lidhur martesë ligjore me z. F. Shedula në datën 10.11.1999, por *de facto* është martuar në dhjetor të vitit 2001 dhe në janar të vitit 2002 kanë filluar kontributet e saj si bashkëshorte dhe si pjesëtare e familjes Shedula.

Nga analiza e provave dhe e fakteve subjekti i rivlerësimit në vitin 2000, rezulton huamarrëse pranë “Fondit B”. Në aktet e depozituar nga institucioni financiar Fondi “B”, citohet se kjo hua merret për qëllime tregtare. Por subjekti në përgjigjet e pyetësorit ka argumentuar se huat janë marrë për ndërtimin e shtëpisë.

¹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Komisioni ka vlerësuar se kontributi i subjektit në këtë pasuri ka filluar më parë se çfarë është pretenduar prej saj. Komisioni ka vlerësuar si moment të fillimit të kontributit financiar të subjektit, referuar aktit zyrtar të lidhjes së martesës.

iii. Regjistrimi i pasurisë

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti me bashkëshortin kanë regjistruar në pronësi të tyre ndërtesën *-katëshe, por nuk kanë në pronësi truallin mbi të cilën është bërë ndërtesa. Referuar lejes së legalizimit nr. ***, datë 31.3.2016, lëshuar për këtë pasuri, ishte parashikuar se: *“Titulli i pronësisë tokën do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”*. Referuar dokumentit hipotekor, të datës 5.05.2016, është bërë regjistrimi vetëm i ndërtesës *-katëshe, por jo i truallit.

Nga verifikimi i akteve të depozituara nga subjekti²⁰, sipas shkresës së ASHK-së Kavajë²¹, në lidhje me pronësinë mbi truallin, rezultoi se: *“Leja e legalizimit nr. ***, datë 31.3.2016, është regjistruar me nr. pasurie **ND, vol. **, f. ***. Kjo ndërtesë pozicionohet në pasurinë nr. ***, vol. **, f. **, në emër shtet. Nga verifikimet e kryera rezulton se me VKKKP-në nr. **, datë 21.4.1994, është njohur e drejta e pronësisë të familjes Shedula për sip. 3608 m², në të cilën pozicionohet ndërtesa e legalizuar”*.

Nga aktet është njohur e drejta e pronësisë mbi truallin, por kjo pronë nuk i është kthyer pronarëve.

Komisioni ka konstatuar se referuar akteve ka rezultuar se subjekti nuk provoi pronësinë mbi truallin në të cilën është ndërtuar shtëpia 3-katëshe, pasi rezulton ende në emër shtet.

iv. Në lidhje me bashkëpronësinë

Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit është bërë bashkëpronare në një pasuri që ishte ndërtuar fillimisht nga vjehri i saj dhe se kontributi financiar filloi pasi pjesa më e madhe e ndërtimit të këtij objektit ishte kryer. Komisioni i kërkoj subjektit të saktësojë bashkëpronësinë në këtë pasuri.

Subjekti ka depozituar përgjigjen e marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Kavajë, ku rezulton se leja e legalizimit është në bashkëpronësi të F dhe Entela Shedula bazuar në VKM-në nr. 1095, datë 28.12.2015, *“Për Përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”*.

Sipas kësaj VKM-je, rezulton se për regjistrimin e lejes së legalizimit, pranë ZVRPP-së përfituesi i lejes së legalizimit duhet të depozitojë *inter alia*, dhe kopje të certifikatës së gjendjes familjare të poseduesit, që disponon ALUIZNI, nga momenti i aplikimit për legalizim.

Më tej, në pikën 20, të VKM-së, parashikohet: *“Leja e legalizimit regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes mbi regjimet pasurore martesore. Për këtë qëllim, personat e interesuar, që përfitojnë lejen e legalizimit, dorëzojnë pranë ALUIZNI-t dokumentin që provon regjimin e veçantë martesor, i cili përcillet pranë ZVRPP-së. Në të kundërt, regjistrimi kryhet sipas regjimit të bashkësisë ligjore”*.

Për këtë arsye bazuar në certifikatën familjare të përcjellë pranë ALUIZNI-t, subjekti figuron e martuar me aplikuesin për regjistrimin e lejes së legalizimit z. F. Shedula. Kjo është arsyeja që regjistrimi i lejes së legalizimit dhe vërtetimi hipotekor rezulton në emër të shtetasve F dhe Entela Shedula.

v. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat “kopsht për fëmijë” i bashkëshortit

²⁰ Subjekti për të provuar pronësinë mbi truallin e ndërtuar ka depozituar:

1. Shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë me nr. *** prot., datë 10.10.2019.
2. Shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë, nr. *** prot., datë 2.3.2020, për statusin ligjor të truallit mbi të cilën është ndërtuar shtëpia *-katëshe.
3. Vendimi nr. **, datë 21.4.1994, i K.K.K. Pronave, fletë shoqëruese, kartelë e pasurisë së paluajtshme, skicë.

²¹ Me shkresën *** prot., datë 2.3.2020.

Nga verifikimi i akteve të depozituara nga subjekti rezulton se z. F. Shedula, ka lëshuar personalisht disa deklarata dore, në të cilat deklaroi të ardhura *neto* nga aktiviteti privat “kopsht për fëmijë”, përkatësisht:

- për vitin 2006 në shumën 350.000 lekë;
- për vitin 2007 në shumën 450.000 lekë;
- për vitin 2008 në shumën 480.000 lekë;
- për vitin 2009 në shumën 606.000 lekë;
- për vitin 2010 në shumën 606.000 lekë;
- për vitin 2011 në shumën 793.840 lekë;
- për vitin 2012 në shumën 793.840 lekë;
- për vitin 2013 në shumën 775.360 lekë;
- për vitin 2014 në shumën 368.777 lekë;
- për vitin 2015 në shumën 274.306 lekë;
- për vitin 2016 në shumën 629.211 lekë.

Për vitet e ushtrimit të aktivitetit 2006 – 2016, ka rezultuar nga DRT-ja Durrës²² se është deklaruar fitim dhe janë paguar tatimet përkatëse nga ky subjekt tatimor, vetëm për vitet 2014 – 2017. Komisioni ka vlerësuar se deklaratat e dorës paraqitur nga subjekti nuk përbëjnë provë për të provuar fitimin e realizuar, në referim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka pretenduar në prapësimet e depozituara se Komisioni duhej të marrë në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti privat “Kopsht për fëmijë” sipas një përlllogaritjeje alternative të *marzhit* të fitimit për vitet ku ka mungesë dokumentacioni për fitimin *neto* në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Bashkinë Kavajë.

Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë pretendimin e subjektit duke reflektuar të ardhurat *neto* nga aktiviteti “Kopsht për fëmijë” në analizën financiare.

vi. Në lidhje me huat pranë institucionit financiar Fondi Besa

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim krijimi për shtëpinë 3-katëshe, ndër të tjera, edhe dy kredi pranë institucionit financiar Fondi B. Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë marrë katër kredi në shumën totale prej 1.800.000 lekësh. Në objektin e kontratave të huas specifikohet se këto hua do merren për qëllim ushtrimi “aktiviteti tregtar”. Referuar formularëve të aplikimit në bankë ka rezultuar se këto kredi do përdoren për aktivitetin tregtar të z. K. Shedula.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimesh, pasi këto kredi janë deklaruar si burim krijimi për shtëpinë, kur ndërkohë janë marrë për aktivitetin tregtar të bashkëshortit.

Subjektit iu kalua barrë prove në lidhje me këtë mospërputhje. Subjekti ka deklaruar²³ se: “*Fondi Besa, nuk jepte kredi për të shtëpi, pasi politika e bankës ishte dhënia e kredive për aktivitet privat. Për këtë arsye bashkëshorti i subjektit ishte i detyruar të merrte kredinë për biznes, e cila u përdor për ndërtimin e shtëpisë*”.

Komisioni vlerësoi se subjekti nuk provoi me dokumentacion të kundërtën e rezultateve të hetimit, për këtë arsye këto kredi nuk janë konsideruar si burim për krijimin e pasurisë.

1.6 Analiza financiare për mundësinë e investimit në ndërtesën *-katëshe

Për të provuar mundësitë financiare të subjektit për ndërtimin e shtëpisë dhe përballimin e shpenzimeve, me burime të ligjshme, Komisioni kreu analizën financiare për familjen e subjektit.

²² Shkresa nr. ***, datë 7.8.2018, dërguar nga DRT-ja Durrës për KPK-në.

²³ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.10.2019.

Fillimisht, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet për ndërtimin e kësaj pasurie, si dhe vitet kur ishte ndërtuar secili kat, u mbështetën në deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve. Mbi bazën e kësaj analize, subjektit iu kalua barra e provës²⁴ për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Komisioni konstatoi se pas analizimit të dokumentacionit, të depozituar nga subjekti dhe të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe pas depozitimit të prapësimeve të saj në datat 10.12.2019 dhe 27.1.2020, subjekti nuk mundi të provojë koston totale të ndërtimit të shtëpisë *-katëshe, sipas deklaratimeve të saj në vlerën 8.450.000 lekë.

Subjekti ka parashtruar se për të kryer një deklaram të saktë në deklaratën “Vetting”, i është drejtuar një ekspert vlerësues të pasurive të paluajtshme me qëllim që të përcaktohej vlera e ndërtimit të kësaj banese. Shuma 8.450.000 lekë, për ndërtimin e shtëpisë është mbështetur mbi raportin e hartuar nga një ekspert vlerësues pasurish të paluajtshme. Subjekti ka argumentuar se referuar aktit të ekspertimit, të datës 6.11.2016, rezultoi se vlera e godinës e përcaktuar nga eksperti është në shumën 8.450.000 lekë. Akti i ekspertimit i është bashkëlidhur deklaratës “Vetting” si provë.

Në mungesë të dokumentacionit, provues mbi stacionet e ndërtimit, si dhe faturave përkatëse për koston e ndërtimit të pretenduar nga subjekti sipas vlerës së deklaruar referuar aktit të ekspertimit depozituar prej saj, mbështetur dhe në praktikën tashmë të standardizuar nga Kolegji i Apelit, për ndërtimet informale, Komisioni, ribëri analizën financiare të subjektit, duke llogaritur shtëpinë e ndërtuar *-katëshe, bazuar në çmimet e referencës sipas Entit Kombëtar të Banesave.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë Entit Kombëtar të Banesave-²⁵, për koston mesatare të ndërtimit për njësi sipërfaqe ndërtimi, e një objekti të ndërtuar nga individë në qytetin e Kavajës gjatë viteve 1995 – 2000. EKB-ja²⁶ ka depozituar informacion mbi çmimet e punimeve të ndërtimit për Kavajën, për vitet 1995 – 2000, si dhe koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuara me VKM-të përkatëse.

Në lidhje me fazat e ndërtimit të kësaj banese, subjekti ka deklaruar²⁷ se shtëpia *-katëshe është ndërtuar në disa faza ndër vite, sipas përcaktimeve të saj. Në mungesë të dokumentacionit provues për të përcaktuar periudhën e saktë të ndërtimit të shtëpisë, Komisioni u bazua në deklaratimet e subjektit dhe kreu analizën financiare për mundësinë e investimit sipas periudhave të deklaruara.

Analizë financiare sipas standardit të EKB-së, për pasurinë ndërtesë * kate, sipas fazave:

Faza 1. Ndërtimi i katit 0 (zero) dhe karabinasë së katit të parë në periudhën 1995 – 1999.

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën nga 1994 – 1999²⁸, duke konsideruar si burim të ardhurat e dokumentuara të bashkëshortit nga emigracioni, që nisin prej vitit 1994.

²⁴ Referuar barrës së provës dërguar subjektit në datën 20.11.2019.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2020.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2020.

²⁷ Në pyetësorin e dërguar Komisionit në datën 16.9.2019.

²⁸ Analiza financiare është kryer që nga viti 1994 duke qenë se të ardhurat nga emigracioni për bashkëshortin e subjektit, të dokumentuara fillojnë nga viti 1994.

Përshkrimi	1994 - 1999
1.Pasuri	6 106 645
Ndërtesa tre kate	5 606 879
Makinë e blerë në 1996	303 061
Makinë e blerë në 1995	196 705
2. Të ardhura	1 902 490
Të ardhura aktiviteti b/sh	86 377
Të ardhura nga emigracioni b/sh	1 271 228
Të ardhura nga pensioni babai i b/sh	297 577
Të ardhura nga pensioni nëna e b/sh	247 308
3. Ndryshim Likuiditetesh	307 994
4. Shpenzime	578 477
Shpenzime jetese	578 477
Rezultati	- 5 090 626

Për periudhën 1994 – 1999 ka rezultuar mungesë burimesh financiare të ligjshme për investimin në ndërtesën *-katëshe dhe mbulimin e shpenzime të kryera, në shumën prej 5.090.626 lekësh.

Faza 2. Ndërtimi i katit të parë, si dhe i karabinasë së katit të dytë, sipas deklarimeve të subjektit në vitet 2000 – 2001.

Pershkrimi	2000-2001
1. Pasuri	2 377 243
Investim ne ndertesen tre kate	2 377 243
2. Te ardhura	2 582 840
Te ardhura nga paga Subjekti	802 281
Te ardhura nga aktiviteti i bashkeshortit	952 509
Te ardhura nga pensioni i babait te b/sh	173 020
Te ardhura nga pensioni i nenes se b/sh	128 966
Te ardhura nga shitja e truallit	475 000
Te ardhura nga interesat bankare te depozitave ne emer te K. Sh	51 064
3. Shpenzime	914 494
Shpenzime jetese	614 494
Shpenzime mobilimi	300 000
4. Likuiditete ne banke ne emer te K.Sh	93 559
Rezultati Financiar	-802 456

Për periudhën 2000 – 2001 ka rezultuar mungesë burimesh financiare të ligjshme për investimin në ndërtesën *-katëshe dhe mbulimin e shpenzime të kryera, në shumën 802.456 lekë.

Faza 3. Ndërtimi i katit të dytë në vitin 2006, me burim të ardhurat nga kredia në shumën prej 2.000.000 lekësh, në “T. B”, *disbursuar* në vitin 2005.

Subjekti, gjithashtu, deklaroi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 shlyerjen e kredisë së marrë në “T.B” në shumën totale prej 371.470 lekësh (interes dhe principal), detyrimi i mbetur në vlerën 1.677.100 lekë. Subjekti deklaroi se kredia është marrë për:

- blerje fugoni në vlerën 250.000 lekë;
- investim në aktivitetin “Kopsht privat” në vlerën 300.000 lekë;
- rikonstrukcionin e shtëpisë ekzistuese në vlerën 200.000 lekë;
- investim në katin e tretë të ndërtesës në vlerën 1.250.000 lekë.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjektit i është *disbursuar* kredia në “Tirana Bank”, në muajin maj të vitit 2005. Sipas verifikimit të *statementit* bankar, subjekti ka tërhequr *cash* shumë në *disbursuar* deri në muajin gusht të vitit 2005. Në vitin 2005 rezulton i blerë vetëm fugoni, ndërsa investimet e tjera janë deklaruar nga subjekti, si të kryera në vitin 2006.

Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, nuk është deklaruar asnjë gjendje *cash* e mbetur nga kredia, e cila ishte tërhequr e gjitha deri në gusht të vitit 2005.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni në datën 22.10.2019, në lidhje me përdorimin e kredisë, subjekti ka deklaruar se: “...*diferenca ka qenë në gjendje cash në shtëpi deri në fund të vitit 2005 ...*”

Subjekti bie në kundërshtim me deklaratat e depozituara në Komision, kur është pyetur në lidhje me shumën *cash* të deklaruar ndër vite, ku sqaron se: “...*shumat e deklaruar janë gjendje e parave cash në shtëpi në fund të vitit*”.

Komisioni nuk morri në konsideratë si burim të ligjshëm për investim në ndërtesën 3-katëshe të ardhurat nga kredia bankare, për faktin se subjekti e ka tërhequr të gjithë shumën e kredisë deri në gusht të vitit 2005, si dhe për faktin se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2005. Për pasojë, nga analiza e kryer ka rezultuar se për vitin 2006, subjekti ka rezultuar me një gjendje negative në shumën - 1.631.673 lekë.

Faza 4. Investimi në shumën prej 1.000.000 lekësh në përfundimin e katit të tretë të ndërtesës, si dhe shpenzime mobilimi në shumën 1.000.000 lekë, me burim kredinë në shumën 2.500.000 lekë në “R. B”, marrë në datën 4.2.2010.

3. Analiza për periudhën 2003 - 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1. PASURI	1 900 000	0	250 000	1 346 436	0	0	685 850	1 499 634	0	0	0	0	0	0
Apartament banimi 60 m2, në emër të B/sh	1 900 000													
Automjet Furgon në 19.12.2005: 250,000			250 000											
Ndertese tre kate, Kavaje				1 346 436				1 499 634						
Autoveturë blerë në 18.02.2009							685 850							
2. DETYRIME	0	0	2 000 000	-219 512	-227 341	-256 357	-288 641	1 187 372	102 179	-827 950	-932 710	-433 660	0	0
Kredi marre ne Tirana Bank			2 000 000	-219 512	-227 341	-256 357	-288 641	-904 769						
Kredi RBAL 2,5 mln lekë 04.02.2010								2 092 141	-502 924	-614 118	-682 288	-292 811		
Kredi Në Credins: 700,000 lekë 20.06.2011									605 103	-213 832	-250 422	-140 849		
3. PASURI NETO	1 900 000	0	-1 750 000	1 565 948	227 341	256 357	974 491	312 262	-102 179	827 950	932 710	433 660	0	0
4. TË ARDHURA	5 005 533	1 459 349	630 131	1 112 647	1 363 559	1 246 280	1 881 776	1 861 700	2 089 493	2 143 817	2 098 315	1 905 024	2 001 885	2 531 160
Të ardhura nga paga Subjekti (2000-2002)	930 697	766 578	630 131	762 647	913 559	766 280	1 001 468	981 392	1 021 345	994 769	1 107 380	1 429 654	1 377 712	1 458 203
Të ardhura nga paga B.sh pranë Kuid, Kuarta						0	274 308	274 308	274 308	241 538	59 343	40 376	78 977	258 418
Të ardhura nga aktiviteti privat i B/sh	1 444 721	458 303		350 000	450 000	480 000	606 000	606 000	793 840	793 840	775 360	373 678	406 200	629 211
Të ardhura nga paga b/sh në aktivitetin e tij privat										113 670	156 232	61 316	138 996	185 328
Te ardhura nga pensioni K. Sh	211 295	150 504												
Te ardhura nga pensioni E. Sh	150 607	83 964												
Te ardhura nga shitja e truallit	675 000													
Te ardhura nga shitja e automjetit Fiat	100 000													
Te ardhura nga emigracioni	1 493 213													
5. SHPENZIME	1 105 944	617 606	714 725	1 127 010	778 906	704 303	730 649	1 829 718	2 273 753	772 822	685 458	1 404 972	1 023 054	1 320 184
Shpenzime jetese	805 944	469 320	438 228	438 228	546 480	546 480	546 480	546 480	546 480	558 192	564 096	879 992	897 104	940 368
TIMS	0	148 286	33 086	0	60 455	0	48 010	9 023	114 789	0	11 918	192 651	125 950	371 316
Shpenzime mobilimi	300 000							1 000 000	800 000					8 500
Kredia 2 mln lekë (Tirana Bank)			243 411	188 782	171 971	157 823	136 159	27 782						
Kredia 2,5 mln lekë (Raiffesien Bank)								232 552	197 159	133 558	64 961	5 725		
Kredi në Credins Bank 700,000 lekë									52 555	81 072	44 483	6 604		
Shpenzime shkollimi H. Fultz														
Shpenzime per pajisje te kopshtit (2006) dhe rikonstrukcion 2011				300 000					300 000					
Shpenzim rikonstrukcioni shtepia e vjeter				200 000										
Pagesë për studime Master- Justiniani								13 881	262 770					
Shpenzime te tjera kredia														
Shpenzime rikonstrukcioni në banesë												320 000		
6. LIKUIDITETE NE FILLIM	0	0	0	36 584	87 946	249 772	1 003 514	951 039	535 369	13 300	741 642	321 561	153 142	441 634
Llogaria e pagës SR RBAL	-	-	-	69	27 997	45 255	253 407	15 409	34 590	2 494	4 576	615	449	16 373
Llogari e A. Sh ne RBAL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	76 346	198 812
Llogari e E. Sh ne RBAL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	76 346	198 661
Llogari ne Tirana Bank e F. Sh	-	-	-	36 515	59 949	4 517	150 107	85 630	779	-	-	-	-	-
Llogari ne Credins Bank e F. Sh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10 806	117 206	20 946	-	60 534
Cash	-	-	-	-	-	200 000	600 000	850 000	500 000	-	619 860	300 000	-	-
7. LIKUIDITETE NE FUND	-	-	36 584	87 946	249 772	1 003 514	951 039	535 369	13 300	811 502	321 561	180 182	544 871	1 338 292
Llogaria e pagës SR RBAL			69	27 997	45 255	253 407	15 409	34 590	2 494	4 576	615	449	16 373	40 015
Llogari e A. Sh ne RBAL													76 346	198 812
Llogari e E. Sh ne RBAL													76 346	198 661
Llogari ne Tirana Bank e F. Sh			36 515	59 949	4 517	150 107	85 630	779					-	60 534
Llogari ne Credins Bank e F. Sh									10 806	117 206	20 946	-	60 534	158 773
Llogari e F. Sh ne Credins Bank (Euro)									69 860				103 238	95 365
Llogari ne Veneto Bank e F. Sh												27 040		
Cash					200 000	600 000	850 000	500 000		619 860	300 000			400 000
REZULTATI FINANCIAR	1 999 589	841 743	1 628 822	-1 631 673	195 487	-468 122	229 111	135 390	439 988	-255 157	900 228	207 772	587 102	314 317

Analizë ligjore

i. Në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë

Për vitet 1994 – 1999, referuar analizës financiare rezultoi mungesë burimesh financiare të ligjshme për investimin në ndërtesën 3-katëshe dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, në shumën 5.090.626 lekë. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për ndërtimin e shtëpisë në këtë periudhë.

Pavarësisht deklaramit të subjektit se kanë kaluar 26 vjet dhe pretendohet se referuar pikës 2, të nenit 32 të ligjit, si në pamundësi objektive, në nivel deklarativ nga subjekti, trupi gjykues në situatën objekt vlerësimi i jep rëndësi fakteve objektive dhe ligjore që janë të lidhura me: a) faktin se një pjesë e ndërtimit është kryer para martesës së subjektit me bashkëshortin; b) faktin se në kohën kur janë përfituar këto të ardhura, por dhe kur është investuar në ndërtimin e shtëpisë për periudhën 1995 – 1999, z. F. Shedula nuk e gëzonte statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe aq më pak statusin e personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues ka konkluduar se gjendja negative e rezultuar nga analiza e kryer për vitet 1994 –1999, nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin me pasojë aplikimin e masës disiplinore.

Për vitet 2000 – 2001, referuar analizës financiare, subjekti ka qenë pjesë e familjes Shedula, celebruar në vitin 1999 dhe ka kontribuar financiarisht për ndërtimin e shtëpisë. Për këtë periudhë, nga analiza financiare ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për investimin në ndërtesën 3-katëshe dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, në shumën - 802.456 lekë.

Për vitet 2003 – 2016, referuar analizës financiare, subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme në investimin në ndërtesën 3-katëshe dhe për të përballuar shpenzimet, konkretisht, sipas viteve sa më poshtë:

- për vitin 2006, mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 1.631.673 lekë;
- për vitin 2008, mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 468.122 lekë;
- për vitin 2012, mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 255.157 lekë.

Komisioni arsyeton se subjekti, me prapësimet dhe provat e paraqitura, nuk provoi bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

ii. Në lidhje me mospërputhjet për burimin e krijimit të pasurisë, ndërtesës 3-katëshe

Subjekti në deklaratën “Vetting” ka listuar një sërë burimesh që nuk janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004. Komisioni arsyeton se saktësia e deklarimeve të subjektit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të saj dhe për të vërtetuar nëse ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë. Jo pa qëllim, ligji e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të kryer deklaramit të saktë dhe të plotë.

iii. Në lidhje me kreditë e Fondit Besa, të deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë

Komisioni nuk u bind me shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me përdorimin e kredive për ndërtimin e shtëpisë, pasi qëllimi i marrjes së tyre ishte për biznes. Kontratat e kredive, nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti, janë akte ligjore referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë fuqinë e ligjit për palët. Në objektin e kontratave dhe në aktet bashkëlidhur përcaktohet qartësisht qëllimi i marrjes së këtyre kredive për aktivitet tregtar.

iv. Në lidhje me pronësinë e truallit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004

Nga subjekti është deklaruar shtëpi banimi me kat përdhes, kat të parë dhe kat të dytë karabina, ndërtuar në truall të përfituar me trashëgimi ndërkohë që nga hetimi i Komisionit, pranuar edhe nga deklaratimet e subjektit, rezultoi se përfitimi i kësaj pasurie nuk ishte me trashëgimi, por pasuri/truall që rezultoi në emër të shtetit, të konfirmuar edhe nga dokumentacioni gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me pronësinë mbi truallin ku është ndërtuar pasuria, subjekti ka parashtruar se kjo është pasuri e trashëguar e familjes Shedula dhe banesa e ndërtuar ndodhet mbi truallin e kthyer me vendim të K.K.K Pronave nr. **, datë 21.4.1994. Në këtë vendim, ndër të tjera, është vendosur: *“Të njohë pronësinë e truallit me sip. 3608 m² katër trashëgimtarëve, sipas dëshirës së trashëgimtarëve nga 1/4 pjesë secilit dhe t'i kthejë sip. prej 2400 m², ndërsa sip. prej 1208 m² ato e disponojnë dhe të bëhet kalimi i pronësisë së katër trashëgimtarëve, trualli me sip. 3608 m²”*. Gjithashtu, subjekti argumenton se kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore me vendimin nr. 1/2009, konkludojnë: *“Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët”*.

Subjekti ka argumentuar se fakti që pasuria e trashëgimtarëve Shedula, mbi të cilën është ndërtuar banesa 3-katëshe e legalizuar nuk është regjistruar pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë nuk e bën të pavlefshëm vendim të K.K.K Pronave nr. 88, datë 21.4.1994, trualli rezultoi në pronësi të bashkëpronarëve Shedula megjithëse rezultoi me statusin shtet, por nuk i jep mundësinë bashkëpronarëve që ta tjetërsojnë te të tretët.

Nisur nga fakti që trualli mbi të cilën ndodhet godina *-katëshe, pozicionohet në pasurinë nr. *** vol. **, f. ** e cila figuron edhe sot në emër shtetit, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka bërë deklaratim të saktë në deklaratën “Vetting” dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, e cila duhet të ishte deklaruar sipas statusit ligjor që ka pasur kjo pasuri, të dokumentuara edhe nga aktet që depozitoi subjekti me vendimin e K.K.K Pronave nr. **, datë 21.4.1994 dhe shkresën e ASHK-së Kavajë nr. *** prot., datë 2.3.2020.

v. Në lidhje me kredinë prej 2.000.000 lekësh, marrë në “Tirana Bank” në vitin 2005, subjekti kërkoi që kjo shumë të përfshihet në analizën financiare si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë, pasi ka pretenduar se e ka disponuar këtë shumë *cash* në shtëpi. Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, nuk e ka deklaruar si gjendje *cash*, pasi e ka deklaruar si kredi të kapitulli i kredive/detyrimeve financiare dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 e ka deklaruar, ndër të tjera, edhe si burim për vijimin e punimeve në ndërtesën 3- katëshe.

Komisioni, duke analizuar të dhënat e bankës nga momenti i *disbursimit* të kredisë, ka evidentuar tërheqje në shuma të ndryshme dhe deri në muajin gusht të vitit 2005 kredia ka rezultuar e tërhequr

tërësisht. Nisur nga ky fakt, trupi gjykues e ka të vështirë të pranojë pretendimet e subjektit se një pjesë të kredisë e ka disponuar gjendje *cash* në shtëpi dhe në vitin 2006 e ka përdorur për investimet në ndërtesën 3-katëshe. Subjekti nuk ishte bindëse në deklaratimet mbi përdorimin e kredisë në vitin 2006, për vijimin e punimeve në ndërtesën *-katëshe.

Për sa më sipër, në lidhje me këtë pasuri ka rezultuar:

- mungesë burimesh financiare të ligjshme për investimin në ndërtimin e banesës 3-katëshe, sipas fazave të ndërtimit të deklaruar nga subjekti;
- deklaram i pasaktë për të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit;
- mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit në deklaratën “Vetting” me deklarimin periodik të vitit 2003;
- deklaram i pasaktë në lidhje me truallin, mbi të cilin është ndërtuar godina *-katëshe.

2. Pasuri apartament me sip. 60 m², ndodhur në K, Kavajë.

Vlera e deklaruar: 1.900.000 lekë.

Pjesa takuese: 100 % në pronësi të z. F. Shedula.

Burimi i krijimit: në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar krijimin nga puna e bashkëshortit si emigrant ekonomik në Itali nga viti 1991 e në vijim; të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit dhe vjehrrit; kredi në Fondin B dhe të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, etj. (trajtuar gjerësisht për pasurinë nr. 1, më sipër).

Subjekti ka bërë deklarimin në deklaratën periodike vjetore se pasuria është blerë me kursimet familjare. Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.5.2003.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Kavajë²⁹ ka konfirmuar se në emër të shtetasit F. Shedula është regjistruar pasuria apartament me nr. ***, me sip. 60 m², në Kryemëdhenj, e përfituar nga kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 5.5.2003.

2.2 Analiza financiare dhe arsyetimi ligjor

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë apartament. Gjithashtu, për periudhën 2002 - 2003 u analizua mundësia e blerjes së apartamentit. Referuar analizës financiare rezultoi se subjekti justifikon me burime të ligjshme blerjen e apartamentit dhe përballimin e shpenzimeve për këtë periudhë, në përputhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës.

3. Automjeti tip “M” fuoristradë, me vit prodhimi 2002, blerë në vitin 2009.

Vlera e deklaruar: 5.000 euro.

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të bashkëshortit.

²⁹ Me shkresën nr.*** prot., datë 5.10.2018.

Burimi i krijimit: kursimet familjare deri në momentin e blerjes. Deklarimi në DPV: burimi i deklaruar nga subjekti me të ardhura të ruajtura nga viti 2008, në vlerën 600.000 lekë dhe pjesa tjetër e fituar gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2009.

Mënyra e fitimit: sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 18.2.2009, me blerës shtetasit I. Shedula dhe F. Shedula. Pala dhuruese I. Shedula, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 7.3.2012, pjesën takuese ia ka dhuruar kushëririt z. F. Shedula.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

DPSHTRr-ja³⁰ konfirmon se automjeti me targa AA *** CY ka qenë në pronësi të shtetasit F. Shedula.

Nga dosja e depozituar nga DPSHTRr-ja rezulton se z. F. Shedula e ka shitur këtë automjet sipas kontratës nr. *** datë 30.1.2018, në çmimin 3.000 euro.

3.2 Analiza e fakteve

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti deklaroi automjetin e blerë me kontratën nr. ***, datë 18.2.2009, në çmimin 5.000 euro.

Burimi i krijimit: lekë të ruajtura në vitin 2008.

Vlera: 600.000 lekë dhe pjesa tjetër e fituar gjatë muajve janar dhe shkurt 2009.

Subjekti, në këtë deklaratë periodike vjetore nuk deklaroi që bashkëshorti zotëron ½ e automjetit, as që kontrata është lidhur nga shtetasit I dhe F. Shedula, në cilësinë e blerësve.

Në dosjen e ILDKPKI-së rezulton kontrata e shitblerjes së automjetit me nr. ***, datë 18.2.2009, sipas së cilës blerës rezultojnë shtetasit I dhe F. Shedula. Ky automjet është blerë me çmimin 5.000 euro, pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale. Certifikata e pronësisë së automjetit dhe leja e qarkullimit janë në emër të të dy blerësve.

Referuar dokumentacionit, ky automjet ka qenë në bashkëpronësi të shtetasve I Shedula dhe F. Shedula. Në dosjen e depozituar nga DPSHTRr-ja rezulton një kontratë dhurimi me nr. *** datë 7.3.2012, sipas së cilës, shtetasi I. Shedula i dhuron shtetasit F. Shedula pjesën e tij të pandarë të automjetit. Dhuruesi deklaroi se pjesa e tij e pandarë e bashkëpronësisë prej ½, mbi këtë automjet ka një vlerë rreth 1.000 euro.

Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar³¹ se z. I. Shedula është kushëri i bashkëshortit (djali i xhaxhait të vjehrrit).

Komisioni ka konstatuar se nuk përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

3.3 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën në bazë të dokumentacionit të administruar për vitin 2008 dhe 2009 për të vlerësuar mundësinë financiare të krijimit të kursimeve për blerjen e automjetit.

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017.

³¹ Me përgjigjet e datës 11.10.2019.

Përshkrimi	2008	2009
1. PASURI	0	685 850
Autoveturë blerë në 18.02.2009		685 850
2. DETYRIME	-256 357	-288 641
Kredi Tirana Bank	-256 357	-288 641
3. PASURI NETO	256 357	974 491
4. TË ARDHURA	1 246 280	1 881 776
Të ardhura nga paga Subjekti	766 280	1 001 468
Të ardhura nga paga B.sh		274 308
Të ardhura nga aktiviteti privat i B/sh	480 000	606 000
5. SHPENZIME	704 303	730 649
Shpenzime jetese	546 480	546 480
Shpenzime udhëtimi		48 010
Shpenzime interesi kredie	157 823	136 159
6. LIKUIDITETE NE FILLIM	249 772	1 003 514
Llogaria e pagës SR RBAL	45 255	253 407
Llogari rrjedhese ne Tirana Bank e Fatmir Shedula	4 517	150 107
Cash	200 000	600 000
7. LIKUIDITETE NE FUND	1 003 514	951 039
Llogaria e pagës SR RBAL	253 407	15 409
Llogari rrjedhese ne Tirana Bank e Fatmir Shedula	150 107	85 630
Cash	600 000	850 000
Rezultati Financiar	-468 122	229 111

Për sa më sipër, referuar analizës financiare, subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe për krijimin e kursimeve *cash* në fund të vitit 2008, në shumën - 468.122 lekë.

3.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar³² se: “*se e gjithë vlera e automjetit është paguar nga bashkëshorti që në vitin 2009. Qëllimi i vendosjes në kontratën shitblerjes së vitit 2009, në cilësinë e blerësit dhe të shtetasit I Shedula është bërë me qëllim që automjeti të përdorej edhe nga ky shtetas për aktivitetin e tij privat. Shtetasi I Shedula nuk ka paguar asgjë për blerjen e këtij automjeti. Për këtë arsye, meqenëse I me letra figuronte si bashkëpronar, në vitin 2012 është përpiluar kontrata e dhurimit. Në thelb, I nuk ka dhuruar asgjë sepse ai edhe pse figuronte si blerës nuk kishte paguar para për blerjen e këtij automjeti*”.

Në lidhje me pamundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka argumentuar se Komisioni, në analizën financiare të kryer, duhet të marrë në konsideratë të ardhurat nga paga, kaluar në bankë për bashkëshortin, ndërkohë që Komisioni ka pranuar si të ardhura ato për të cilat janë

³² Datë 10.12.2019 dhe ato të datës 9.3.2020.

paguar siguracione të vërtetuara nga ISSH-ja. Nisur nga ky fakt, bashkëshorti ka depozituar një padi ndaj punëdhënësit për mospagim dhe deklarim të shumave respektive sipas viteve.

Në lidhje me analizën financiare dhe gjendjen negative që ka rezultuar për vitin kur është blerë automjeti, subjekti ka pretenduar se duhet të merret në konsideratë fitimi i llogaritur me metodë alternative i aktivitetit privat të bashkëshortit.

3.5 Arsyetimi ligjor

Referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore.

Në përputhje me këtë dispozitë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, janë përfshirë vetëm të ardhurat e dokumentuara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

4. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara³³ të bashkëshortit të subjektit, z. F. Shedula

³³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kopje leje qëndrimi italiane (carta di soggiorno) nr. B***, lëshuar për shtetasin F. Shedula për periudhën nga data 11.3.2003 deri më 10.3.2013, tek e cila konstatohet se për herë të parë ky shtetas është pajisur me leje qëndrimi në datën 11.3.1996 me qëllim punësimit. Kopje datë 2.1.2017 nga nxjerrja e llogarisë në INPS (instituti nacional i shërbimit social italian) në të cilën konstatohet se shtetasi F. Shedula ka punuar nga data 1.1.1994 deri më 14.5.2003 dhe ka përfitur shumën totale prej 30.931 euro. (Aneks nr.4/3)
- Kthim-përgjigje nr. ***, datë 12.3.2015 nga DRT-ja Durrës, në të cilën konfirmohet se shtetasi F. Shedula është regjistruar me vendimin e gjykatës nr. 28, datë 17.1.1995, me NIPT ***H dhe kod fiskal nr. ***, me aktivitet tregti me shumicë të artikujve të përzierë ushqimorë, pije dhe duhan. Ky subjekt është çregjistruar më 1.1.2004. Bashkëlidhur janë dorëzuar bilancet për periudhën 1999-2004, ku konfirmohen se fitimet *neto* janë, si vijon: për vitin 1999 është minus -88.300 lekë, në këtë bilanc është pasqyruar fitimi *neto* i vitit 1998 në shumën 174.677 lekë; për vitin 2000 është në shumën 515.019 lekë; për vitin 2001 është në shumën 437.490 lekë; për vitin 2002 është në shumën 588.747 lekë; për vitin 2003 është në shumën 855.974 lekë; për vitin 2004 është në shumën 458.303 lekë. Për vitin 2005 ka bashkëngjitur formularin e deklaratimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar dhe deklaratë me shkrim dore në të cilën deklarohet se ka krijuar fitime për vitin 2005, në shumën 222.240 lekë. Ekstrakt historik të regjistrimit të personit fizik me NIPT J *** H (Aneks nr.4/4).
- Shkresa nr. *** prot., datë 14.11.2016, nga ISSH-ja e cila konfirmon se shtetasi F. Shedula figuron i regjistruar në subjektin “K” sh.p.k. me dosje nr. ***, për periudhën janar 2009 - dhjetor 2012. Bashkëngjitur shkresat përcjellëse nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë dhe vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën *bruto* prej 35.200 lekësh në muaj.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB-ja më 23.1.2017 për shoqërinë “K” sh.p.k.
- Vërtetime nga shoqëria “K” sh.p.k. nr. ** prot., datë 7.4.2011 dhe nr. ** prot., datë 18.3.2012, të cilët konfirmojnë se shtetasi F. Shedula është punonjës nga data 9.5.2008 e në vazhdim dhe paguhet me pagën mujore 70.000 lekë.
- *Statement* lëshuar nga “Tirana Bank”, nxjerrje llogarie nr. *** EA e zotëruar nga shtetasi F. Shedula për periudhën 1.1.2008 - 31.12.2011, tek e cila janë depozituar pagat gjatë kësaj periudhe.
- *Statement* lëshuar nga “Credins Bank” me nr. llogarie ***, e zotëruar nga shtetasi F. Shedula për periudhën 9.3.2011- 30.6.2014, tek e cila janë depozituar pagat gjatë kësaj periudhe (Aneks nr.4/10).
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB-ja më 23.1.2017, për shoqërinë “K” sh.p.k.
- Vërtetime nga shoqëria “K” nr. ** prot., datë 27.3.2014 dhe nr. ** prot., datë 10.3.2015, të cilët konfirmojnë se shtetasi F. Shedula është punonjës nga data 2.9.2013 e në vazhdim dhe paguhet me pagë mujore 65.000 lekë.
- Shkresa nr. ** prot., datë 24.10.2016, nga banka ‘Societe Generale Albania’, e cila bashkëngjiti nxjerrje llogarie nr. *** e zotëruar nga shtetasi F. Shedula për periudhën 17.9.2013 - 30.7.2015, ku janë depozituar pagat gjatë kësaj periudhe.
- Shkresa nr. *** prot., datë 20.10.2016 nga banka “Veneto”, e cila bashkëngjiti nxjerrje llogarie nr.***, e zotëruar nga shtetasi F. Shedula për periudhën 31.12.2009- 30.9.2015, ku janë depozituar pagat gjatë kësaj periudhe.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB-ja datë 23.1.2017 për shoqërinë “AKF P” sh.p.k.
- Vërtetime nga shoqëria “AKF P” sh.p.k., nr. *** prot., datë 18.3.2016 dhe nr. ***prot., datë 23.12.2016, të cilët konfirmojnë se shtetasi F. Shedula është punonjës nga data 17.9.2015 e në vazhdim dhe paguhet me pagë mujore 30.000 lekë dhe 45.000 lekë (*neto* + orë shtesë).
- Shkresa datë 20.10.2016 nga “Credins Bank”, e cila bashkëngjiti nxjerrje llogarie nr.*** e zotëruar nga shtetasi F. Shedula për periudhën 6.10.2015- 4.1.2017, ku janë depozituar pagat gjatë kësaj periudhe. Vendim gjykate nr. ** datë 13.2.2006, me të cilin është regjistruar shtetasi F. Shedula me aktivitet privat “Kopsht për fëmijë”. Ekstrakt historik i personit fizik F. Shedula i regjistruar më 1.3.2006 me aktivitet “Kopsht për fëmijë”.
- Deklarata dore të lëshuara nga shtetasi F. Shedula, në të cilat ai deklaroi të ardhura *neto* nga aktiviteti: për vitin 2006 në shumën 350.000 lekë, për vitin 2007 në shumën 450.000 lekë, për vitin 2008 në shumën 480.000 lekë, për vitin 2009 në shumën 606.000 lekë, për vitin 2010 në shumën 606.000 lekë, për vitin 2011 në shumën 793.840 lekë, për vitin 2012 në shumën 793.840 lekë, për vitin 2013 në shumën 775.360 lekë, për vitin 2014 në shumën 368.777 lekë, për vitin 2015 në shumën 274.306 lekë, për vitin 2016 në shumën 629.211 lekë.

- Të ardhura të përfituara si emigrant ekonomik në Itali në vitet 1994 – 2003, në shumën totale 30.935 euro.
- Të ardhura nga aktiviteti privat, tregti me shumicë të artikujve të përzierë, ushqimorë, pije dhe duhan për vitet 1995, 1998, 2000, 2001 – 2005, gjithsej shuma e të ardhurave *neto* 3.252.450 lekë.
- Të ardhurat nga puna te shoqëria “K” sh.p.k., me NIPT K***O, për vitet 2008 – 2015, gjithsej të ardhura *neto* në shumën 5.122.270 lekë.
- Të ardhurat nga puna te shoqëria “AKF P” sh.p.k., me NIPT L***V, për vitet 2015 - 2016 ka përfituar shumën *neto* prej 595.000 lekësh.
- Të ardhura nga aktiviteti privat kopsht për fëmijë me NIPT K***U, fitimi *neto*, sipas deklaratave të lëshuara për vitet 2006 – 2016, është në shumën 6.127.334 lekë.
- Të ardhurat nga pensioni i z. K. Shedula, për periudhën 16.3.1988 – 30.10.2015, në shumën *neto* prej 2.782.162 lekësh.
- Të ardhurat nga pensioni i znj. E. Shedula, për periudhën 1.4.1993 – 31.10.2016, në shumën *neto* prej 2.156.348 lekësh.
- Z. A.Sorra, arsimtar, të ardhura *neto* për periudhën 1996 – 2001, në shumën e të ardhurave *neto* prej 922.360 lekësh.
- Znj. L.Sorra, arsimtare, të ardhura *neto* për periudhën 1996 – 2001, në shumën e të ardhurave *neto* prej 812.911 lekësh (nuk kanë lidhje me pasurinë e deklaruar).

4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

-
- Vërtetim nga Bashkia Kavajë i lëshuar më 22.12.2016 për xhiron e parashikuar nga viti 2007 deri në vitin 2013 për subjektin F.Shedula, i cili është i regjistruar me NIPT K***H me aktivitet “Kopsht për fëmijë”. Për vitin 2007 në shumën nga zero deri në 2.000.000 lekë dhe për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013 në shumën nga 2.000.000 lekë deri më 3.000.000 lekë. Ky subjekt ka shlyer të gjitha detyrimet pranë bashkisë nga viti 2007 e deri në datën e lëshimit të vërtetimit.
 - Vërtetim nga Bashkia Kavajë i lëshuar më 29.12.2016 i subjektit F. Shedula i cili është i regjistruar me NIPT K***H me aktivitet “Kopsht për fëmijë”. Ky subjekt ka shlyer të gjitha detyrimet pranë bashkisë nga viti 2007 e deri në datën e lëshimit të vërtetimit. (Aneks nr.4/9).
 - Vërtetim nga Bashkia Kavajë nr. *** prot., datë 26.3.2007 për qarkullimin vjetor në shumën 2.000.000 lekë të subjektit F. Shedula, i cili është i regjistruar me NIPT K***U me aktivitet “Kopsht për fëmijë”.
 - Deklaratë dore datë 26.3.2007 e lëshuar nga shtetasi F. Shedula, në të cilën ai deklaroi të ardhura nga aktiviteti për vitin 2006 në shumën 350.000 lekë.
 - Shkresa nr. *** prot. datë 11.1.2017 nga DRT-ja Durrës, e cila konfirmon se tatimpaguesi F.Shedula është i regjistruar në DRT Durrës me NIPT K***H me aktivitet “Kopsht për fëmijë” dhe ka dorëzuar deklaratat e TFTH-së, nga të cilat rezulton se për vitin 2014 fitimi është në shumën 398.678 lekë, për vitin 2015 fitimi është në shumën 431.200 lekë. Bashkangjitur dërgohen dhe pasqyrat financiare të vitit 2012, nga ku rezulton se shuma e arkëtimit është në vlerën 1.964.600 lekë.
 - Pasqyra përmbledhëse e treguesve financiarë të tatimpaguesit F. Shedula me NIPT K***H me aktivitet “Kopsht për fëmijë”: për vitin 2009 fitimi në shumën 606.000 lekë, për vitin 2010 fitimi në shumën 606.000 lekë, për vitin 2011 arkëtime në shumën 1.984.600 lekë, për vitin 2012 arkëtime në shumën 1.964.600 lekë, për vitin 2013 arkëtime në shumën 1.938.400 lekë, për vitin 2015 fitimi në shumën 274.306 lekë. FDP për vitin 2016 nga i cili rezulton se fitimi është në shumën 629.211 lekë. (Aneks nr.4/9).
 - Vërtetim nga ISSH-ja, nr. *** prot., datë 24.10.2016, për të ardhurat që ka përfituar shtetasi K. Shedula nga pensioni në shumën totale 2.782.162 lekë, për periudhën nga data 16.3.1988 deri më datë 30.10.2015.
 - Vërtetim nga ISSH-ja, nr. *** prot., datë 21.10.2016, për të ardhurat që ka përfituar shtetasja E. Shedula nga pensioni në shumën totale 2.156.348 lekë për periudhën 1.4.1993 - 31.10.2016.
 - Vërtetim nga ISSH-ja për të ardhurat që ka përfituar shtetasi A. Sorra nga paga *neto* në shumën totale 922.360 lekë për periudhën 1.1.1996 - 31.12.2001.
 - Vërtetim nga ISSH-ja për të ardhurat që ka përfituar shtetasja L. Sorra nga paga *neto* në shumën totale 812.911 lekë për periudhën 1.1.1996 - 31.12.2001.

DRT-ja Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2017, ka konfirmuar se shtetasi F. Shedule(a) figuron i regjistruar me NIPT J***H me objekt aktiviteti, tregti me shumicë e artikujve të përzierë ushqimorë, pije, duhan.

DRT-ja Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2018, ka konfirmuar se shtetasi F. Shedula figuron i regjistruar me NIPT J***H. Referuar bilanceve të dorëzuara nga subjekti dhe përgjigjes së DRT-së Durrës, të ardhurat *neto* nga aktiviteti me NIPT J***H, për periudhën 1998 – 2004, janë në shumën 2.941.820 lekë.

ISSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, ka konfirmuar se:

- shtetasi F. Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën janar 2012 – nëntor 2012, si i punësuar në shoqërinë “K” me NIPT K***O.
- shtetasi F. Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën nga shtator 2013 – dhjetor 2014, si i punësuar në shoqërinë “K” me NIPT L***U.
- shtetasi F. Shedula ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën shtator 2015 – prill 2017, si i punësuar në shoqërinë “AKF P” me NIPT L***V.
- shtetasi F. Shedula ka përfituar të ardhura nga paga në shumën *neto* prej 700.000 lekësh për periudhën prill 2012 – mars 2017, si i punësuar te subjekti tregtar F. Shedula, me NIPT K***H .

DRT-ja Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2017, ka konfirmuar se shtetasi F. Shedula është regjistruar në datën 20.3.2006, me NIPT K***H, me aktivitet “kopsht për fëmijë”, me adresë: Rr. “Q. K”, lagjja nr. *, objekt *-katësh, k. *, me status aktiv prej datës 18.4.2015.

4.2 Analiza financiare për të ardhurat e bashkëshortit

Subjekti deklaron se ka realizuar të ardhura nga aktiviteti privat, por nuk ka provuar me dokumentacion të ardhurat për periudhën 1995 – 1997, pasi bilancet nuk ekzistojnë. Për qëllime të analizës janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar tatime dhe, konkretisht, për vitet 1998 - 1999. Pasqyra e detajuar e fitimit *neto* jepet në tabelën vijuese:

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Total
Fitimi <i>neto</i> sipas DRT-së Durrës	174 677	- 88 300	515 019	437 490	588 747	855 974	458 303	nuk ka informacion	2 941 910
Fitimi <i>neto</i> i deklaruar në Vetting	174 677	- 88 300	515 019	437 490	588 747	855 974	458 303	222 240	3 164 150

Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat “Kopsht për fëmijë” për periudhën 2006 – 2016.

- Nga informacioni zyrtar nga DRT-ja Durrës vërtetohet se për subjektin tregtar në emër të z. F. Shedula, janë paguar tatimet për periudhën 2014 – 2016 dhe se fitimet *neto* të realizuara, për të cilat janë paguar tatimet janë në shumën totale prej 1.409.089 lekësh.
- Për qëllim të analizës, Komisioni ka marrë në konsideratë fitimin e viteve 2014 – 2016, për të cilat është paguar tatim.
- Për vitet e ushtrimit të aktivitetit, 2006 – 2013, Komisioni vlerësoi të reflektojë në analizën financiare fitimin *neto* nga aktiviteti privat “Kopsht për fëmijë”, sipas një përlllogaritjeje alternative të *marzhit* të fitimit për vitet ku ka mungese dokumentacioni për fitimin *neto* në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Bashkinë Kavajë.

Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga paga pranë shoqërive të lidhura: “K”, “AKF P” dhe “K”

Subjekti, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga punësimi i z. F. Shedula pranë këtyre shoqërive për periudhën 2008 – 2016, ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të ardhura nga bashkëshorti në shumën prej 5.717.270 lekësh.

Referuar dokumentacionit të ardhur, shoqëritë pranë të cilave ka punuar z. F. Shedula, kanë paguar detyrimet tatimore për shumën totale prej 1.501.576 lekësh.

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar nuk përputhen deklaratimet e subjektit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimet pranë shoqërive “K”, “AKF P” dhe “K”, me dokumentacionin e ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim

Subjekti, në prapësime, ka pretenduar se Komisioni duhet të merrte në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit, nga pagat e kaluara në bankë, dhe jo ato për të cilat janë paguar siguracione, të vërtetuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Detyrimi për mbajtjen dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale, referuar legjislacionit tatimor në fuqi, ka qenë i punëdhënësit dhe jo i punëmarrësit. Nisur nga ky fakt, bashkëshorti i subjektit ka depozituar padi civile ndaj shoqërive punëdhënëse pas kalimit të barrës së provës, ku pretendon se nuk ka pasur dijeni mbi mospagimin e tatimeve mbi të ardhurat nga punëdhënësit, shoqëritë “K”, “AKF P” dhe “K”.

Arsyetimi ligjor

Komisioni, për të vlerësuar të ardhurat e ligjshme, analizoi informacionin zyrtar të ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe dokumentacionin e ardhur nga bankat, ku pasqyrohen kalime periodike të të ardhurave nga paga në llogaritë në emër të bashkëshortit të subjektit. Të ardhurat e përfituara me bankë kanë rezultuar në shumën **5.460.035 lekë**, ndërsa të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore kanë rezultuar në shumën prej 1.501.576 lekësh.

Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit dhe pagat e përfituara nga punësimi pranë shoqërive “K”, “AKF P” dhe “K”. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se pasuritë e ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula:

- i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve.
- iii. Ka deklarim të pasaktë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit.
- iv. Deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, me detyrë gjyqtar/drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.6.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore³⁴
Etmonda Hoxha

³⁴ Për arësye objektive sekretarja Gjyqësore Etmonda Hoxha ka qenë në mungesë, ditën e shpalljes së vendimit